Kronikë

# Transportonte 5 kallëpë lëndë eksplozive C4 dhe 5 kapsolla detonatore, arrestohet 44-vjeçari në Shijak

*Një 44-vjeçar, i identifikuar si Flamur Dani është arrestuar nga policia e Shijakut pasi u kap duke transportuar 5 kallëpë lëndë eksplozive C4 dhe 5 kapsolla detonatorë.*




Redaksia
13 Shtator, 13:22 | **Përditesimi: 13 Shtator, 14:34**

Një 44-vjeçar, i identifikuar si Flamur Dani është arrestuar nga policia e Shijakut pasi u kap duke transportuar 5 kallëpë lëndë eksplozive C4 dhe 5 kapsolla detonatorë. Ai akuzohet për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

Në kuadër të operacionit policor të koduar 'Stacioni', 44-vjeçari, banues në Manzë u kap në flagrancë në Maminas, kur sapo kishte zbritur nga një automjet i transportit publik. Gjatë kontrollit të ushtruar në çantën e shpinës së të arrestuarit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 5 kallëpë lënde plasëse C4 dhe 5 kapsolla detonatore.


LEXO EDHE:
**Fushë-Krujë, apeli i nënës së dy fëmijëve jetimë: Më ndihmoni! Burri më vdiq, shtëpia po shembet**

Vijon puna, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për identifikimin dhe kapjen e personit që do të blinte lëndët plasëse, si dhe për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të veprimtarisë kriminale të Danit.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për veprime të mëtejshme.




A.M./Shqiptarja.com

TAG: kapsolla donatore | lende eksplozive | Arrestime | shijak | Durres

Komento

## Komente

**Beni:** 13/09/2022 13:26
Denojeni per terrorizem kete rrace bastarde se po terrorizojne njerez sikur jemi ne Afganistan
Përgjigju

**ZjarrPervelues:** 13/09/2022 14:18
Ka te drejte Beni. Ky nuk eshte ligj, ky nuk eshte shtet. Duhet se sben te hetohet per trafikim te lendeve plasese, qe sjellin vrasje dhe terror per grupet e strukturuara kriminale. Nese nuk vertetohet trafikimi te behen ligje te reja dhe te denohet mbajtja dhe transportimi i lendes plasese me dy nene te ndryshme.

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Jeni dakord me propozimin e PD-së për zhdukjen e veprave të artit të krijuara gjatë diktaturës?**

PO | JO | NUK E DI

## Lajme të tjera

Kronikë


Durrës/ Transportuan 2275 ton naftë kontrabandë me anije çisternë nga Libia në Shqipëri, 4 në pranga, 3 libian dhe 1 sirian
13 Shtator, 11:09

Kronikë

Misteri i atentatit në Durrës! Qëllohet në drejtim të makinës së maqedonasit, pranë kaloi një person me precedent penal, i shoqëruar nga nipi i ish-ministrit të LSI
13 Shtator, 10:25

Sociale

527 turistë amerikanë mbërrijnë në Durrës me kroçierën 'Nautica', do vizitojnë qendrat muzeale dhe arkeologjike (VIDEO)
13 Shtator, 10:06

Kronikë

Merr flakë në ecje makina në Durrës, Report Tv sjell videon
12 Shtator, 20:32

Kronikë

U dyshua se ishte mbushur me naftë kontrabandë nga rebelet në Bengazi i Libisë, ndalohet për kontroll anija në Portin e Durrësit! Rezulton e rregullt
12 Shtator, 19:02

Kronikë

Arrestohen dy persona në Durrës! 28-vjeçari dhunoi të ëmën, 41-vjeçarit iu gjet kokainë në makinë
12 Shtator, 11:07

Sociale

12 gjimnaze dhe shkolla 9-vjecare në rindërtim në Durrës, problem mësimi me turne
12 Shtator, 11:05

Kronikë

U arrestua pasi nuk kishte shlyer dënimin për armëmbajtje pa leje, Apeli në Durrës liron Ballist Morinën
12 Shtator, 10:43

Kronikë

Operacion 'blic' në Krujë, Policia në kërkim të personave të rrezikshëm kriminalë
10 Shtator, 23:03

Kronikë

Kontrabanda e naftës në Durrës, Gjykata vendos masat e sigurisë! 20 ditë burg për kapitenin e anijes, i lirë i vëllai
Aldo Mustafa
10 Shtator, 15:31

Kronikë

U ndërtuan pa leje e zaptuan hapësirat publike, nis puna për prishjen e lokaleve në hyrje Durrësit (VIDEO)
9 Shtator, 10:07

Kronikë

Antikontrabanda Detare në Durrës bllokon peshkarexhën 'Leon' me 25 mijë litra naftë, do hidhej në treg! Pranga kapitenit e marinarit
7 Shtator, 08:04



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje